

# **RAPORT TEKNIK**

**Objekti: "Rikualifikim urban i shesheve të pallateve të shembura në territorin e Nj.A.Fushë Krujë"**

**Autor i Projektit  
“ERALD - G” shpk**



**VITI - 2023**

## **PERMBAJTJA E RAPORTIT TEKNIK**

### **1. TE PERGJITHSHME**

**1.01 Hyrje**

**1.02 Vend Ndodhja e objektit**

**1.03 Gjendja Egzistuese**

**1.04 Foto Gjendja Egzistuese**

### **2. ZGJIDHJA E PROJEKTIT**

**2.01 Projekti i Rruges**

**2.02 Detaje**

## **1. TE PERGJITHSHME**

### **1.1 HYRJE**

#### **1-Te pergjithshme**

Fushë Kruja ndodhet rreth 20 km ne veri te qytetit të Tiranës. Shtrihet rreth kuotes 20-25m mbi nivelin e detit, eshte zone fushore e kodrinore, me pjerresi te terrenit 1.5-10% me drejtim lindje-perendim. Ne afersi te saj ka disa kodra te vogla me lartesi 80-120m mbi nivelin e detit.

Rritja e ritmeve te zhvillimit ne vendin tone, dhe atij turistik ne veçanti, kerkojne investime te vazhdueshme si per permiresimin e rrjetit rrugor ekzistues, po ashtu edhe te ndertimit te rrugeve te reja per t’iu pergjigjur trafikut gjithmone ne rritje.

Shoqeria projektuese (konsulente) “Erald-G”shpk ne baze te termave te references (detyres se projektimit), ka kryer studim-projektimin e kesaj rruge te re, ka kaluar te gjitha fazat sipas programit te hartuar, duke filluar nga:

- Projekt idea
- Takime ne ish Bashkinë F-Krujë (sot Nj.A.Fushë Krujë)

Projekti permban:

1. Studimin e Projekt Idese
2. Studimin e Ambjentit
3. Relacionin teknik qe permban nje pershkrim te pergjithshem per zonen, te dhena mbi gjendjen ekzistuese te rruges, pershkrimin mbi hartimin e projektit, llogaritjet e shtresave rrugore, llogaritjet konstruktive, etj.
4. Specifikimet teknike
5. Vizatimet e punes si: planimetrine e pergjitheshme te ndertimit, profilin gjatesor, profilat terthore tip, planimetrite e disiplinimit te ujrave, projektin e ndricimit, vizatimet konstruktive, te gjitha detajet dhe hollesite, etj.
6. Preventivin perfundimtar per fazen e pare te ndertimit.

Si shoqeri konsulente per hartimin e projektit jemi bazuar tek standartet dhe kushtet teknike shqiptare (keto kushte teknike shtrihen ne studimin dhe projektimin e rrugeve te reja dhe rindertimin e rrjetit rrugor egzistues te Republikes se Shqiperise). Per veprat e artit jemi bazuar ne kushtet teknike te projektimit per rruge te kategorise se pare.

## 2- KUSHTET KLIMATIKE DHE HIDROLOGJIKE

### **KUSHTET KLIMATIKE**

Hidrologjia e krahinës së Krujës (përfshirë qytetin Fushë Krujë), varet së pari nga klima, së dyti nga topografia dhe gjeologjia. Faktorët klimatikë të një rëndësie parësore janë rreshjet dhe mënyra e perhapjes së tyre, lagështia, temperatura dhe era, të cilat ndikojnë në avullimin dhe transpirimin.

Faktorët klimatikë të cilët janë marrë në konsideratë në analizë përfshijnë:

- Temperatura e ajrit,
- reshjet dhe analiza e tyre,
- bora dhe
- era.

Të dhënat që mbështesin këtë analizë janë marrë nga vendmatjet të zgjedhur dhe janë përmbledhur në tabelën 2.1

Regjistrimet klimatike nga stacionet klimatologjike mund të konsiderohen përfaqësuese të kushteve të pritura në Fushë Krujë. Statistika klimatike të publikuara për periudhën nga 1942 janë përmbledhur në tabele.

### **POPULLSIA**

Te gjitha te dhenat mbi popullsinë e Fushë Krujës u dhane nga ish bashkia dhe ne detyren e projektimit. Popullsia e Fushë Krujës deri në vitin 2012 nga të dhënat e ish bashkisë është 15000 banorë (referuar zonës urbane, ndërsa si Njësi Administrative rreth 26000 banorë). Studiumi demografik japin të dhëna të përafërta me ato të ish bashkisë.

### **EKONOMIA**

Fushë Kruja renditet në qendrat me një zhvillim të mirë ekonomik, tregtare të vendit. Jo vetëm qyteti Fushë Krujë, por i gjithë rrethi në teresi ka luajtur historikisht një rol shumë të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të krejt vendit.

Ne kete zone jane te mundshme per t'u zhvilluar te gjitha aktivitetet ekonomike. Megjithate midis tyre vlen te veçohen sektore te tille si industria e prodhimit te inerteve, e mobilerise, ekonomia bujqesore.

#### **- Rilevimi Topografik dhe Hartat Baze.**

Rilevimi topografik i nevojshem eshte kryer me metoden Total- station.

Pikat topografike do te vendosen gjate procesit te rilevimit. Ato jane kunja celiku me bazament ose shenjim ne ndertime te perhershme. Nivelet e pikave topografike do te bazohen ne te dhenat Shqiptare; afersisht gjashte do te vendosen ne cdo 100m<sup>2</sup> ne zonat e banuara dhe cdo 10.0-20.0m pergjate rrugëve te hyrjeve.

Te gjitha hartat jane ne formate elektronike bashke me nje pale kopje te riprodhueshme.

° Jane percaktuar ndertimet e perhershme dhe te perkohshme, shkarkimi I ujrave te zeza , muret rrethuese, gardhet portat e hyrjeve, kufijte e parcelave. Jane treguar objektet ne ndertim.

° Ne planimetri jane dhene tubat kryesore, pusetat e ujrave te zeza dhe pusetat e kontrollit te shtrira ne siperfaqen e tokes.

° Jane dhene dhe percaktuar linjat e Energjise Elektrike, linjat e tensionit,shtyllat,transformatoret, lidhjet me banesat, ndricimi rrugor.

° Ne punimet topografike jane hedhur rruget dhe kalimet, dallohen rruget e shtruara dhe gjurmet e tyre.

° Mbeturinat e ngurta jane trajtuar dhe tregohen vendodhjet e kazaneve te plehrave ose vendet e hedhjeve te mbeturinave.

Rrjeti telefonik do te tregohet dhe te percaktohen linjat , kabinat telefonike etj.

Hartat e perdorura per hartimin e ketij projekti , jane ne shk.1:500,1:1000,1:2000 dhe 1:10000. Ne hartat baze te zones ne shkallen 1:1000 dhe 1:500 te siguruar nga “Erald-G” eshte hedhur azhornimi i zones me kuotat gjeodezike te zones, ka azhornim te banesave te reja te ndertuara ne kete zone ne 10 vitet e fundit.

Projekt-zbatimi eshte punuar mbi hartat e shkalles 1:500 dhe 1:200 e detajet sipas rastit, te marre nga Zyra e Urbanistikes.

**Sheshet e pallateve të shembura në territorin e Nj.A.Fushë Krujë**  
ndodhen në gjendje tejet të amortizuar ku duken si gërmadha, pa llogaritur që prej vitesh në to nuk janë kryer investime me gjithë shqetësimin e vazhdueshëm të banorëve dhe institucioneve

vendore si dhe pas prishjes së pallateve si pasojë e dëmtimeve nga termeti, gjendja është bërë emeregjente. Në këto sheshe e rrugë vlen të theksohet mungesa e sinjalistikës. Shtresat asfaltike ne pjesen me te madhe rruges jane egzistuese por atyre u duhet bere nje skarifikim pasi jane jashte gjendjes per te mbajtur trafikun qe krijohet ne kete rruge, pasi janë amortizuar thuajse totalisht, duke e bërë këto akse rrugore të shesheve të pakalueshëm e të papërdorshëm dhe burim aksidentesh e rreziku.

Objekti “**Rikualifikim urban i shesheve të pallateve të shembura në territorin e Nj.A.Fushë Krujë**” është planifikuar të realizohet me fonde të buxhetit të Bashkise për këtë vit.

Objekti i këtij studimi është rikualifikimi i shesheve e i rrugëve ekzistuese dhe kthimi i saj në gjendje normale e të përdorshme nga qytetaret.

## 1.02 Vend Ndodhja e Objektivit

Objekti “**Rikualifikim urban i shesheve të pallateve të shembura në territorin e Nj.A.Fushë Krujë**”;

Sheshet dhe rrugët respektive ne fjale ndodhen në zonën urbane të qytetit Fushë Krujë, duke filluar nga sheshi para bashkisë që është dhe sheshi më i madh pasi veç sheshit të pallatit nr.12 përshin gjithë sheshin dhe rrugët funksionale që lidh Nj.A.Fushë Krujë, Shkollën e mesme “Shote Galica” dhe Kopështin e fëmijëve Nr.1 me qendrën e qytetit, po ashtu dhe sheshet e pallateve nr.9, 20, 30, 40, 44, 46.



## 1.03 Gjendja Aktuale e Objektivit

Ky objekt përbëhet nga 7 nënobjekte/ sheshe pallatesh për tu rikualifikuar, ku sheshi më i madh dhe më i rëndësishëm është ai i pallatin nr.12, pranë zyrave të Njesisë Administrative Fushë Krujë. Gjendja aktuale e sheshit pranë zyrave të Njesisë A.Fushë Krujë është mjaft e rënduar, ku aktualisht pjesa dërrmuese e tij është i amortizuar, me shtresë sipërfaqësore me pllaka betoni të thyera e amortizuara, po ashtu edhe sheshi i pallatin nr.12, ku pas prishjes së tij kanë mbnetur disa gërmadha e rrënoja, po ashtu edhe disa shtesa objektesh, të cilat duhen prishur dhe i tërë sheshi duhet sistemuar. Gjithashtu duhen ndërprerë disa lidhje uji e shkarkimesh.

Ashtu si sheshi i pallatit nr.12 paraqitet gjendja edhe e 6 shesheve të pallateve të tjera, ku aktualisht i është bërë një sistemim sipërfaqësor vetëm me qëllimin e parandalimit të ndonjë rreziku të mundshëm apo për sistemimin e inerteve për mospengimin e lëvizjes së këmbësorëve por akoma ka rrënoja nga pallatet e prishura apo pjesë objekti (shtesa) pa u prishur.

## **2. ZGJIDHJA E PROJEKTIT**

### **Projekti i Rruges/ shesheve**

Ajo do te kete nje gjeresi variable nga 3-20 m , dhe do te perbehet nga :

- trupi i rruges i asfaltuar me gjeresi variable.
- kunetat me gjeresi 0.5 m nga te dy anet e rruges.
- Trotuaret me gjërësi të përgjithshme variabël(0.2 m bordurë/variabël pllaka, 0.1m kundrabordurë).

Rruga e projektuar ruan pergjithesisht aksin e gjurmes se rruges egzistuese duke bere permiresimet e mundshme gjeometrike te rruges brenda normatives se standartit, por edhe ndonjë përmirësim jashtë territorit të rrugës aktuale, duke u zgjeruar/ spostuar mbi truallin e ish pallateve ekzistuese.

Të gjitha hapësirat publike të 7 pallateve të prishura, si pasojë e shpalljes së tyre si të pabanueshme, do të sistemohen, me punime kryesisht që konsistojnë në realizimin e nënshtresave, shtresave, bordurave të betonit, kundrabordurave e kunetave monolite, rrugicave me beton/pllaka trotuari, vendosjen e stolave, koshave të mbeturinave, ndricuesve dekorativ, pemëve dhe sipërfaqeve të gjelbëruara.

Sheshi para bashkisë do të rikonceptohet dhe zgjerohet, në funksion të krijimit të hapësirave më të mëdha për qarkullimin e mjeteve, krijimit të sipërfaqeve të gjelbërta, parkimeve për Institucionin, invalidët dhe qytetarët, ndërhyrje të cilat do të prekin edhe rrethimin aktual të godinës së Nj.A.F-Krujë.

- **Shtresat ne trup te rruges**

Paketa e propozuar e shtresave rrugore e percaktuar nga studimi i kryer do te permbaje keto shtresa :

- Profilim me çakëll makinerie  $t_{mes}=10cm$ .
- Shtresë me çakëll makinerie  $t_{mes}=20cm$ .
- Shtresë stabilizanti  $t=10cm$ .

- Shtresë binderi t=6cm.
- Shtresë asfaltbetoni t=4cm.

Kjo pakete e shtresave rrugore do të ndërtohet pasi të jenë bërë punimet e skarifikimit të rruges, dhe pasi trupi i rruges (bazamenti) të jetë cilindruar. Shtresa e pare do të shërbejë edhe si shtrese profiluese e rruges.

### **Shtresa e Bazes**

Shtresa e bazës është parashikuar të profilohet aty ku është e nevojshme me çakëll me një trashësi totale 10 cm. Kjo përfaqëson një shtresë materiali të selektuar ose stabilizanti me granulometri në kufijte nga 0.425 mm deri në 20 mm. Rekomandimet për shpërndarjen granulometrike të grimcave të këtij materiali të selektuar jepen në tabelën e mëposhtme:

<u>Permasat e sites (mm)</u>	<u>Kalojnë siten (% në peshe)</u>
50	–
37.5	–
28	100
20	90 – 100
10	60 – 75
5	40 – 60
2.36	30 – 45
0.425	13 – 27
0.075	5 – 12

Pra sic shihet, materiali i thyer duhet të përmbajë fraksione të imeta në kufijte nga 5 – 12% me tregues të plasticitetit jo më të madh se 6%. Kjo shtresë e kompaktuar duhet të ketë një vlerë minimale të CBR > 80 për një densitet të kerkuar në fushe sa 98% e densitetit maksimal në gjendje të thatë të arritur nga prova e Proctor-it të modifikuar.

Pas profilimit me çakëll makinerie realizohen shtresa e çakëllit t=20cm dhe shtresa e stabilizantit t=10cm, me të njëjtat karakteristika si më lart (shih specifikimet teknike).

### **Shtresat Asfaltike**

Paketa e shtresave asfaltike është llogaritur të jetë 10 (6 +4) cm. Ajo përbehet nga shtresa e lidhese (binder course) 6 cm dhe shtresa konsumuese (wearing course) 4 cm. Trashësia prej 6 cm e shtresës lidhese është përcaktuar në baze të vlerës së ESALs =  $1.6 \times 10^6$ , pasi për vlera ESALs <  $2.0 \times 10^6$ , trashësia minimale e shtresës së pare asfaltike (binderit) rekomandohet të jetë jo më e vogël se 6 cm.



Permasat e sites (mm)	Kalojne siten (% ne peshe)	Kalojne siten (% ne peshe)
	Shtresa Konsumuese	Shtresa Lidhese
50		–
37.5		100
25	100	90 – 100
19	90 – 100	–
12.5	–	56 – 80
4.75	35 – 65	29 – 59
2.36	23 – 49	19 – 45
0.3	5 – 19	5 – 17
0.075	2 – 8	1 – 7

Per realizimin e asfaltobetoneve agregatet e kombinuara duhet te jene te graduara mire (pra, me gradim te vazhdueshem). Tabela e mesiperme tregon gradimin e rekomanduar per shtresen konsumuese dhe shtresen lidhese:

Projektimi i perzierjeve per asfaltobetonet e shtreses lidhese dhe shtreses konsumuese rekomandohet te behet mbi bazen e metodës "Marshall". Meqenese vlere e percaktuar me siper e ESALs <  $5 \times 10^6$ , rekomandojme qe projektimi i perberesve te asfaltobetonit te filloje me nje permbajtje bitumi qe jep rreth 4% porozitet ne perzierje. Vetite e perzierjes se projektuar te shtresave asfaltike duhet te permbushin kriteret e projektimit sipas metodës "Marshall" te dhena ne Tabelen e meposhtme:

Ngarkesa e trafikut te projektimit ( $10^6$ ESALs)	1 - 5
Niveli i ngjeshjes	2 x 75
Poroziteti ne agregate VMA (%)	Min. 11 - 16
Poroziteti ne perzierje VIM (%)	3.5 – 4.5
Poroziteti ne agregat te mbushur me bitum VFB (%)	65 – 75
Qendrueshmeria minimale (kN)	8.0
Rrjedhja (mm)	2.0 – 3.5

### **Kunetat**

Kuneta eshte e parashikuar me beton C20/25 ne njeren ane te rruges, ne pjesen me trotuar te saj.

## **Kasoneta**

Ne pjesen qe rruga do te zgjerohet nga ajo egzistuese do te behet nje kasonete me lartesi mesatare 30cm. Pjesa e germuar do te mbushet me cakell rifjuto.

## **Projekti i Sinjalistikes Rrugore**

Ne projektin e sinjalistikes rrugore eshte parashikuar Sinjalistika Horizontale dhe ajo Vertikale.

- **Sinjalistika Horizontale** perbehet nga :


1. Vijezimet

a) Vijezimi do te behet ne te dy anet dhe ne aksin e pjeses se asfaltuar, me gjeresi 10 deri 15cm sejcila.

b) Ne zonat prane degezimeve dhe kryqezimeve rrugore, do te vijezohet me vije te nderprere.

c) Ne zonat e banuara dhe tek shkolla, do te vijezohet per kalim kembesoresh.

### TIPET E VIZIMEVE TE RRUGES



- **Sinjalistika Vertikale** perbehet nga :

Tabelat treguese

**SHENJA LAJMERUESE**

---

LAJMERIM PER NDERPRERJE NGA RRUGE DYTESORE, KTHESAT E KURBEZUARA, FEMIJET, KEMBESORET DHE PER NDALJE/DHENIE RRUGE

---

TREKENDSHI: E KUQE REFLEKTUESE  
SFONDI: I ZI  
SYMBOLI: E BARDHE REFLEKTUESE



**Shenim :** Projekti i Sinjalistikës, gjatë zbatimit të objektit, mund të ndryshohet në varësi të skemës së qarkullimit, që do të jepet nga Investitori, duke ju referuar projektit, preventivit përkatës dhe ndryshimeve të mundshme që mund të pësojë projekti gjatë zbatimit.

**Gjelbërimi dhe koshat e mbeturinave.**

Në dy anët e trotuarit është parashikuar mbjella e fidanëve tip Blini, me të dhëna sipas specifikimeve përkatëse, çdo 6ml si edhe shkurre dekorative tip “Oleander”.

Po ashtu është parashikuar dhe vendosja e disa kazanëve të vegjël mbeturinash në dy anët e rrugës.

**Ndriçimi rrugor.**

Në anën e jashtme të rrugës/ sheshit është parashikuar vendosja e disa shtyllave metalike me H=7m, me ndriçues LED.

**Punime nëntokësore.**

Në të gjitha shtresat dhe nënshtresat e pallateve ekzistuese të prishura, janë parashikuar punime për infrastrukturën nëntokësore si mbyllja dhe nxjerrja jashtë funksioni i linjave ekzistuese të pallateve të cilat nuk do të jetë e nevojshme të përdoren më, zgjatja/shtrirja e linjave të reja të ujit të pijshëm/ kub/ kuz/ elektrike për objektet e tjera të cilat do të vazhdojnë së funksionuari si Nj.A.Fushë Krujë, shkollat, kopështi nr.1, bizneset përreth.

Per:

**“ERALD-G” Sh.p.k.**

---

**Ing. Gezim ISLAMI**  
ADMINISTRATOR